VENDIM
Nr. 893, datë 27.12.2022

PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT "EKIPET SPORTIVE NË SHKOLLA", NË KUADËR TË LËVIZJES OLIMPIKE SHQIPTARE, DHE PËR AKTIVITETE NË KUADËR TË NDËRKOMBËTARIZIMIT TË SPORTEVE TË KOMITETIT OLIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR (KOKSH)

(Ndryshuar me VKM nr. 705, datë 6.12.2023; nr. 632, datë 10.10.2024; nr. 856, datë 26.12.2024; nr. 424, datë 23.7.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të neneve 13 dhe 15, të ligjit nr. 79/2017, "Për sportin", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin, në masën 1 058 000 000 (një miliard e pesëdhjetë e tetë milionë) lekë, të projektit "Ekipet sportive në shkolla", në kuadër të lëvizjes olimpike shqiptare të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), dhe financimin, në masën 200 000 000 (dyqind milionë) lekë, të projektit "Ekipet sportive në shkolla", në kuadër të lëvizjes olimpike shqiptare të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), dhe për aktivitete në kuadër të ndërkombëtarizimit të sporteve, të ndara, si më poshtë vijon:

a) 250 000 000 (dyqind e pesëdhjetë milionë) lekë nga fondet buxhetore të vitit 2022;

b) 350 000 000 (treqind e pesëdhjetë milionë) lekë nga fondet buxhetore të vitit 2023;

c) 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekë nga fondet buxhetore të vitit 2024;

ç) 200 000 000 (dyqind milionë) lekë nga fondet buxhetore të vitit 2024, për projektin "Ekipet sportive në shkolla", dhe për aktivitete në kuadër të ndërkombëtarizimit të sporteve;

d) 308 000 000 (treqind e tetë milionë) lekë nga fondet buxhetore të vitit 2025, për projektin "Ekipet sportive në shkolla", nga të cilat 298 000 000 (dyqind e nëntëdhjetë e tetë milionë) lekë për projektin "Ekipet sportive në shkolla", dhe 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë për shahun, pjesë e të njëjtit projekt.

2. Fondi i përcaktuar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, transferohet në llogarinë e KOKSH-it, në bankën e nivelit të dytë dhe përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2022 *dhe buxheti i miratuar për vitin 2023, buxheti i miratuar për vitin 2024, si dhe buxheti i miratuar për vitin 2025* për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, përkatësisht, në llogarinë ekonomike 604 "Transferta të brendshme", në programin buxhetor 08140 "Zhvillimi i sportit".

3. KOKSH-i, brenda muajit janar 2023 *dhe brenda muajit shkurt 2024*, *dhe brenda muajit shkurt 2025, si edhe brenda muajit gusht 2025, përkatësisht për financimet sipas shkronjave "a", "b", "c", "ç" dhe "d" të pikës 1, të këtij vendimi*, të paraqesë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit projektin e detajuar dhe të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e tij, duke identifikuar të gjitha aktivitetet/produktet dhe infrastrukturën e parashikuar në projekt, kohëzgjatjen e zbatimit të projektit, federatat dhe organizmat e tjerë përfitues nga projekti. Projekti duhet të jetë i kostuar me të gjithë produktet/zërat analitikë të shpenzimeve, në përputhje me klasifikimin ekonomik buxhetor të tyre.

4. KOKSH-i raporton periodikisht mbi bazë katërmujore në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për ecurinë e aktiviteteve/produkteve dhe realizimin financiar të projektit. *Brenda muajit gusht 2025 të depozitohet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit raporti vjetor i veprimtarisë së projektit "Ekipet sportive në shkolla", përfshirë raportimin financiar.*

5. Ministria e Arsimit dhe Sportit cakton një grup pune për mbikëqyrjen e realizimit të mbështetjes financiare të KOKSH-it. Përbërja dhe detyrat e grupit të punës përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama